



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

V E N D I M

Nr. 99, Datë 02/09/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 47, datë 05.06.2020, e z. A.B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”¹, nga ana e Bashkisë Skrapar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se nëpërmjet Vendimit nr. 85, datë 03.07.2018, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, ankuesi A.B. është emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Kabinetit të Kryetarit pranë Bashkisë Skrapar. Marrëdhënia e punës mes palëve është rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të Punës.

Si rezultat i zgjedhjeve të zhvilluara në 30 Qershor 2019, Bashkia Skrapar pati ndryshim të titullarit të institucionit. Nga momenti i ardhjes në detyrë të Kryetarit të ri, të Bashkisë Skrapar, i

¹ Referuar Kartës së Anëtarësisë nr. 14006, datë 15.07.2016, ankuesi është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

cili është përfaqësues i Partisë Socialiste, ankuesi pretendon se ndaj tij ka filluar diskriminimi për shkak të bindjeve të tij, politike. Me anë të Vendimit nr. 114, datë 18.11.2019, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, ankuesi është shkarkuar nga detyra, me motivacionin e kryerjes së ndryshimeve strukturore pranë këtij institucioni.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 47, datë 05.06.2020, e z. A.B., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Skrapar sh.a. me shkresën nr. 730, datë 12.06.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 - Akti i emërimit të ankuesit në pozicionin e Përgjegjës të Kabinetit të Kryetarit, pranë Bashkisë Skrapar;
 - Kopje të kontratave individuale të punës së ankuesit dhe Bashkisë Skrapar;
 - Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ku të përfshihen akti i njoftimit, procesverbali i takimit dhe vendimi i lirimit nga detyra;
 - Struktura organike aktuale dhe ajo e mëparshme e Bashkisë Skrapar;
 - Informacion nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë Bashkisë Skrapar;
 - Numri i punonjësve të Bashkisë Skrapar të liruar nga detyra me të njëjtin motivacion sikurse ankuesi;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

- Lista e emrave të punonjësve të larguar nga puna, përgjatë periudhës kohore qershor – dhjetor 2019, ku të reflektohet pozicioni që kanë mbajtur këta punonjës, data e saktë e emërimit dhe lirimit nga detyra dhe motivacioni i largimit;
 - Numri i punonjësve të Bashkisë Skrapar, që janë larguar me doreheqje, brenda së njëjtës periudhë kohore;
 - Informacion mbi punonjësin, që ka zëvendësuar ankuesin, në pozicionin Përgjegjës i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Skrapar;
 - Informacion nëse ankuesi e ka kundërshtuar gjyqësisht Vendimin nr. 114, datë 18.11.2019, e Kryetarit të Bashkisë Skrapar. Nëse po, të përcillet pranë Komisionerit një kopje e kërkesëpadisë së z. A.B. kundër Bashkisë Skrapar, si dhe një kopje e vendimit gjyqësor;
1. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur të KMD-së, Bashkia Skrapar ka dërguar shkresën nr. 1716/1, datë 03.07.2020, nëpërmjet së cilës sqaron se largimi nga puna i z. A.B., është bërë për shkak të ndryshimeve strukturore, pas miratimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve nga ana e Këshillit të Bashkisë Skrapar në Vendimin nr. 07, datë 27.08.2019 *“Për rishikimin e buxhetit dhe numrin e punonjësve të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi për vitin 2019”* dhe Vendimit nr. 20, datë 29.08.2019 e Kryetarit të Bashkisë Skrapar *“Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave për Bashkinë Skrapar dhe njërive në varësi të saj për vitin 2019”*, ku është bërë pozicionim i punonjësve sipas strukturës së re dhe pozicioni i Përgjegjës të Kabinetit të Kryetarit nuk është pjesë e kësaj strukture. Ankuesi e ka kundërshtuar Vendimin nr. 114, datë 18.11.2019 dhe aktualisht çështja ndodhet në shqyrtim pranë gjykatës së shkallës së parë Berat.

4. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Ankuesi A.B. është emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Kabinetit të Kryetarit pranë Bashkisë Skrapar, nëpërmjet Vendimit nr. 85, datë 03.07.2018, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar. Marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës së lidhur ndërmjet

ankuesit dhe Kryetarit të Bashkisë Skrapar. Kontrata e punës ka qenë me afat 3 muaj e në vijim, ajo është bërë me afat të pacaktuar në bazë të parashikimit të nenit 149/2, të Kodit të Punës.

Në referencë të Vendimit nr. 74, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak, *“Për miratimin e strukturës së punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj për vitin 2018”* (e ndryshuar) rezulton se Kabineti i kryetarit të Bashkisë Skrapar përbëhej nga 8 punonjës, si vijojnë: 1 Kryetar, 2 Nënkryetarë, 1 Këshilltar, 1 Sekretar i Këshillit, 1 Sekretare e Kryetarit dhe Marëdhëniet me Publikun, 1 specialisti i auditit dhe 1 inspektori i ndërtimit.

Për sa më sipër, referuar akteve të depozituara nga Bashkia Skrapar në cilësi prove rezulton se mbështetur në Urdhërin nr. 39, datë 26.06.2018, *“Për ndryshim strukture”*, të ish-Kryetarit të Bashkisë Skrapar është shtuar Pozicioni i Shefit të Kabinetit, i cili paraprakisht nuk bënte pjesë në organikën e këtij institucioni. Referuar pikave 1 dhe 2, të këtij urdhëri citohet:

“1.Të shkurtohet:

1.1 Pozicioni i Inspektorit të Ndihmës Ekonomike.

1.2 Pozicioni i Protokoll Arkivës në Njësinë Administrative Vëndreshë, në varësi të Bashkisë Skrapar.

1.3 Pozicioni ekonomist/Nd. Ekonomike në Njësinë Administrative Zhepë.

2. Të shtohet:

*2.1.**Pozicioni i Shefit të Kabinetit në Bashkisë Skrapar.***

2.2.Pozicioni i Protokoll-Arkivës, në Njësinë Administrative Bogovë.

2.3.Pozicioni i Administratorit në Njësinë Administrative Zhepë.”

Nëpërmjet Urdhërit të sipërpërmendur rezulton se ish-Kryetari i Bashkisë Skrapar, në vitin 2018, ka shkurtuar disa pozicione pune dhe ka shtuar disa të tjera. Në këtë kontekst, Komisioneri konstaton se pozicioni i Shefit të Kabinetit në Bashkinë Skrapar është shtuar pranë Bashkisë Skrapar në qershor të vitit 2018 e në vijim në datën 03.07.2018 është kryer emërimi i z. A.B. në këtë pozicion pune.

Në vijim, pas ardhjes në detyrë të Kryetarit të ri të Bashkisë Skrapar, struktura organizative e këtij institucioni për vitin 2019 ka ndryshuar sërish. Nëpërmjet Vendimit nr. 07, datë 27.08.2019, të Këshillit të Bashkisë Skrapar *“Për rishikimin e buxhetit dhe numrin e punonjësve të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi për vitin 2019”* është përcaktuar numri i

përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Skrapar. Referuar këtij vendimi rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve për këtë vit është 347 punonjës, ku bashkia dhe institucionet e varësisë kanë 339 punonjës dhe funksionet e deleguara, gjendja civile dhe QKB kanë 8 punonjës. Në vijim, mbështetur në numrin e përgjithshëm të punonjësve të përcaktuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, i cili është konfirmuar edhe nga Prefektura Skrapar, me Vendimin nr. 20, datë 29.08.2019, e Kryetarit të Bashkisë Skrapar *“Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave për Bashkinë Skrapar dhe njërive në varësi të saj për vitin 2019”* ka ndryshuar struktura organike e këtij institucioni. Sipas kësaj strukture, Kabineti i Kryetarit të Bashkisë Skrapar përbëhet nga 10 punonjës, sipas pozicioneve vijuese: 1 Kryetar, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 1 Nënkyetar, 1 Nënkyetare, 1 Këshilltar për Çështjet e Pushtetit Vendor, 1 Sekretare e Kryetarit, 1 Sekretare e Këshillit, 1 punonjës i Auditit të Brendshëm, 1 inspektor i mbrojtjes së territorit, si dhe Njësia për koordinim dhe integrim europian dhe ndihmës së huaj, që përbëhet nga 1 specialist.

Nëpërmjet kësaj strukture janë suprimuar disa vende pune. Si rrjedhim 8 punonjës janë larguar nga puna, si pasojë e suprimimit të pozicionit të punës. Një ndër ta është edhe ankuesi A.B., i cili ka punuar në këtë pozicion pune deri në datën **18.11.2019**, e cila është edhe data e largimit të tij nga detyra e Përgjegjës të Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, nëpërmjet Vendimit nr. 114, datë 18.11.2019, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar. Referuar këtij vendimi rezulton se motivacioni i shkarkimit të z. A.B. është *“për shkak të ndryshimeve strukturore”*.

Për sa më sipër, në bazë nenit 64, gërmat g) e j), të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* Kryetari i Bashkisë Skrapar emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njërive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil, si dhe miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Kryetari i Bashkisë Skrapar ka vepruar brenda tagrave ligjore për hartimin dhe miratimin e strukturës organike të institucionit që ai drejton, duke formatuar kabinetin e tij, sipas mënyrës që ai e ka gjykuar më efikase, duke shkurtuar pozicionin e përgjegjës të kabinetit. Njëkohësisht, në nenin 5, pika 5.3, gërma b), të Kontratës Individuale të Punës së z. A.B. me Bashkinë Skrapar parashikohet shprehimisht: *“Punëdhënësi ka të drejtë të largojë nga puna punëmarrësin kur:b) Kur shkërtohet vendi i punës si rezultat i shkurtimit të strukturës me vendim të Këshillit të Bashkisë”*.

Në kushtet kur përveç z. A.B., ka patur edhe shkurtime të disa pozicioneve të tjera pune, në interpretim të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Bashkisë Skrapar.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nuk mund të ketë diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të z. A.B., për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Skrapar
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha- Punësim
Shkak –bindja politike
Lloji i vendimit - mosdiskriminim